



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:080769

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05639608

P.nr.136/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpuntoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.... L.... nga Gjilani, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 i KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.349/2024 të datës 11.03.2024, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan për dhënien e urdhrit ndëshkimor, pas konstatimit se të dhënat në aktakuzë ofrojnë bazë të mjaftuar për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me datë 22.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan për dhënien e urdhrit ndëshkimor me shenjën P.II.nr. 349/2024 të datës 11.03.2024, andaj kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Kundër të pandehurit: R... L..., nga babai O., i lindur më datë, ..., me vendbanim në lagjen Dardania I 3/6 në Gjilan, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR S E P S E

Prej datës së pavërtetuar deri me datën 23.12.2023, në shtëpinë e tij në lagjen” Dardania I “në Gjilan, i pandehuri R.... L... si shfrytëzues i energjisë elektrike, me qëllim që vetit t’i sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, ka vjedhur energjinë elektrike, ashtu që pas kontrollimit

nga zyrtarët e autorizuar të KEDS-it është konstatuar se i pandehuri, si konsumator i energjisë elektrike, ka bërë vjedhjen e energjisë elektrike, ashtu që ka bërë një lidhje direkte në rrjetin elektrik pa pikë matëse dhe në këtë mënyrë ka bërë harxhimin e paautorizuar të energjisë elektrike, duke e dëmtuar, të dëmtuarën KEDS- distrikti ne Gjilan, në vlerë prej 2.478.08 €uro.

-Me çka ka kryer veprën penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së.

Prandaj, në bazë të nenit 4,31,38,40,43,të KPRK-ës si dhe të nenit 495 par. 1.1 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

DENIM ME GJOBË

Ashtu që i akuzuari dënohet me dënim me gjobë në shumë prej **200 (dyqind e euro)€**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimi me gjobë me pajtimin me të akuzuarit do ti zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20€ (njëzet euro) ndërsa nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë me punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20€(njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

E dëmtuara KEDS- për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë shumën prej 20€, si dhe në emër të kompensimit për viktimat e krimit të paguaj shumën prej 20€, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën P.II.nr.349/2024 të datës 11.03.2024, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 i KPRK-së dhe njëherësh gjykatës i ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe shqiptimin e dënimit me gjobë me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me besueshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtet e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykuese me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPPK-së dhe konform nenit 495, par. 1, 2 dhe 3 të KPP-së, dhe vendosi që të pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv.

Kjo gjykatë, konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, si vijon: procesverbal me nr 2190450, i datës 23.12.2023, foto-dokumentacion nga vendi i ngjarjes, Fatura nga kalkulimi i RH, me nr.502602 i datës 10.01.2024, Fatura mbi dëmin e shkaktuar me nr. DGLHP 2413829, i datës 10.01.2024, si dhe shkresat tjera përcjellëse.

Palën e dëmtuar KEDS e udhëzoj në kontest civil, konform nenit 462 të KPP-së si dhe për shpenzimet e procedurës vendosi në bazë të nenit 452.1 të KPP-së

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 495 paragrafi 1,2 dhe 3 të KPP-ës gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
P.nr.136/2024 me datë 22.04.2024

Gjyqtari

Veli Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri mund të paraqes kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimin të të njëjtit.